



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA



01.09.2023

| REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA | | | |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| MARRE NË DORËZIM - PRIMLJENO RECEMET | | | |
| Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit | Numri Braj Number | Shtojca Prilog Appendix | Vlera Vrednost Value |
| 01 | 016 | 59133 | 8 |

Procesverball nga Degjimi Buxhetor me banorë të Bllacës dhe fshatrave për rreth për projekt buxhetin e komunes për vitin 2024



KOMUNA SUHAREKË Procesverbal i Degjimeve Buxhetore

Publikimet në webfaqe, platforme të konsultime publike si dhe rrjetin social facebook:

<https://kk.rks-gov.net/suhareke/degjime-publike/kab-2024-2026/>

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

<https://www.facebook.com/KomunaSuharekeZyrtare/>

Dëgjimi buxhetor me banorë të Bllacët dhe fshatrave për rreth në komunën e Suharekë u mbajtë më: 23.08.2023 në objektin e shkollës fillore në Bllacë, me fillim në ora 18:00.

- Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pramnishëm ishin: 37
- Femra ishin: 11

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimin e shpalli të hapur Kryetari I Komunes Bali Muharremaj.

Kryetari Bali Muharremaj: E hap takimin dhe I përshendet qytetaret e pranishëm.

Agim Bylykbashi: përshendet të pranishmit, prezanton KAB-in dhe projektet kapitale, sqaron në vija të trasha buxhetin për vitin 2024.

Kryetari Bali Muharremaj: duke ju uruar mireseardhje tregon rendesin për vitin 2024 rreth buxhetit komunal, kerkon nga qytetaret rekomandime rreth kërkesave të tyre.

Fyrnizimi me ujë në fshatin Bllacë është project jetik për mua, por Hidroregjioni merret me kujdesin e ujit dhe të kanalizimeve. Shpesh qytetaret me telefonojnë për zgjidhjen e problemeve të kanalizimit. Kemi me u marr me rrugë kanalizime, fushë sportive, parqe dhe trotuarë. Jemi këtu me I ndëgju kërkesat e juaja. Kemi pak probleme me prokurim, me OSHB, kualiteti është pak I dobët por çmimi na imponon.

Kemi pastruar ambientin te Mrizat por duhet caktuar vendin për mbeturina të ngurta.

Ymer Lumi: kam kerkesë për kanalizimin (lagjen Lumi te Shelgjet) kundermonë erë teper e keqe. Kam edhe një kerkesë për rrugë, duhet rrugë fushore me kalu nëpër ara, Kemi nevojë për ndihmen tuaj kryetar.



KOMUNA SUHAREKË Procesverbal i Degjimeve Buxhetore

Kryetari Bali Muharremaj: jep sqarim dhe tregon për rruget në projekt për vitin 2024: "Vlora", "Prrocka", "Mrizet", "Kroni I shelqes", "Malësia", "Rruga Livadhet", "Lama", "Mehmet Lumi" degëzim, "Bislim Zekolli" degëzim.

Ismet Fangu: mërgimtar I kënaqur me punën. Kam problem me rrugë del e pengon një person është rrugë e cila nuk mbyllet këtë natë ka dhënë edhe gjykata, është rrugë me therra, kërkojmë me shtrë. Një person I pengon disa qytetarë gjatë rrugës dhe e kemi të pamundur me lëviz lirshëm.

Gazmend Lumi: kemi dy problem një me kanalizim, era kundermon tepër shumë, dhe ka problem shumë duhet intervenim I shpejtë. Problem I dytë është ndriqimi në atë rrugë që nuk është funksional funksional për momentin.

Ali Iballi: problem është te kanalizimi afër xhamisë në fshat, te rruga "Blini", kundermon tepër erë.

Sadri Guraziu: te lagja Guraziu është premtu një shesh, park për fëmijë.

Valbona Kuqi: problem është te parkingu I shkollës paraqet rrezik për fëmijët.

Nazmi Lumi: paraqet problem rryma te lagja Lumi

Ismet Guraziu: kërkesë për rrugë fushore e cila është e nevojshme. Kërkesa e dytë dy fusha janë të mbyllura kërkohet të hapet një rrugë pasi që janë fusha punuese.

Fatmir Pirku: rruga te lagja Guraziu të rregullohet.

Adem Derguti: prioriteti është te arsimit.

Kryetari Bali Muharremaj: Faleminderit juve që ishit prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 19:10

Vegëza në webfaqe për mbajtjen e degjimit publik:

<https://kk.rks-gov.net/suhareke/news/%f0%9f%93%8dbllace/>

Vegëza në facebook për mbajtjen e degjimit publik:

<https://www.facebook.com/KomunaSuharekeZyrtare/>